

MIE

REPUBLIKA E SHQIPERISË

ZYRA E NOTERISË Tiranë

NR. 9021 Rep.

NR. 3584 Kol.



**KONTRATË**

**PËR NDËRTIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE ADMINISTRIMIN E HIDROCENTRALIT  
"RRËSHEN" ME KAPACITET PRODHUES 0.250 MW,  
NË PELLGUN UJËMBLEDHËS TË PËRROIT TË RRËSHENIT, DEGË E LUMIT FAN I  
VOGËL, BASHKIA MIRDITË, QARKU LEZHË**

Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, më datë 19, muaji Dhjetor, viti 2018 (dy mijë e tetëmbëdhjetë), para meje noter Mimoza Shehu, anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë Pr. A. Frashëri 3/3, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**, që në vijim do të citohet "MIE", përfaqësuar me autorizimin nr. 14360/3 prot. datë 23.11.2018 nga z. Agim Bregasi, shtetas shqiptar, lindur në [redacted] banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. personal [redacted] madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**DHE**

**Mbajtësit të miratimit**, Shoqëria "Nikolli Energy" sh.p.k., e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKB me NIPT L61517025M, datë 15/03/2016 regjistrimi, me seli në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.5, rruga Perlat Rexhepi, Pallati 1, Kati 1, Ap.10, Shqipëri, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. Arber Nikolli, shtetas shqiptar, lindur në Rrëshen, [redacted] mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. personal [redacted] madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

MIE dhe Mbajtësi i Miratimit Shoqëria "Nikolli Energy" sh.p.k., në vijim referohen individualisht si "Pala" dhe së bashku si "Palët".

**Hyrje**

Duke patur parasysh se:

1. Mbajtësi i Miratimit, Shoqëria "Nikolli Energy" sh.p.k., mbështetur në pikën 2 të nenit 49 të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe në Vendimin nr. 822, datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni" të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, ka aplikuar për marrjen e miratimit, për ndërtimin e objektit, hidrocentralit "Rrëshen", me kapacitet prodhues 0.250 MW, në pellgun ujëmbledhës përroit të Rrëshenit, degë e lumit Fan i Vogël, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë.

[Handwritten signatures in blue ink]

2. MIE me miratimin përfundimtar Nr. 14360/1 Prot., datë 23.11.2018, ka miratuar ndërtimin e Hidrocentralit "Rrëshen" me kapacitet prodhues 0.250 MW, në pellgun ujëmbledhës të përroit të Rrëshenit, degë e lumit Fan i Vogël, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë.
3. Mbajtësi i miratimit, Shoqëria "Nikolli Energy" sh.p.k., e cila është e interesuar të investojë me qëllim realizimin e ndërtimit të hidrocentralit "Rrëshen", në pellgun ujëmbledhës të përroit të Rrëshenit, degë e lumit Fan i Vogël, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, ka hartuar studimin e plotë të fisibilitetit teknik, mjedisor dhe social, si dhe projektin e zbatimit të bazuar në të dhëna dhe matje reale, të kryera në zonat e zbatimit të projektit të cilat janë pjesë integrale të kësaj kontrate.
4. Mbajtësi i Miratimit, Shoqëria "Nikolli Energy" sh.p.k., zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiarë, për të realizuar projektin e zbatimit për të cilin është kryer oponenta teknike nga AKBN (Raporti i Oponentës Teknike Nr. 4363/5 Prot., datë 31.07.2017 mbi projektin e zbatimit të HEC-it "Rrëshen").
5. Mbajtësi i Miratimit, Shoqëria "Nikolli Energy" sh.p.k., zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këtë investim në përputhje me praktikat më të mira.

Palët lidhin këtë kontratë bazuar në pikën 2 të nenit 49 të Ligjit nr. 43/2015 datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", në VKM-në nr. 822 datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", i ndryshuar, dhe bien dakord për sa më poshtë:

## KREU I DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizime dhe interpretime

Kurdoherë që përdoren në këtë kontratë (duke përfshirë edhe Aneksat e saj), përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtme do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

1. **Kontrata:** Kjo kontratë, anekset dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj.
2. **Ligji "Për sektorin e energjisë elektrike":** Ligji nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", ligji nr.7/2017, datë 2.2.2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme";  
**VKM-ja për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni:** VKM-ja nr. 822 datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", i ndryshuar;

Çështjet e kontratës që nuk rregullohen me aktet ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, janë subjekt i dispozitave të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994. "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar.

3. **Ministria:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

**Mbajtësi i miratimit:** Shoqëria "Nikolli Energy" sh.p.k., mbajtëse e të drejtës së ndërtimit të hidrocentralit "Rrëshen", shoqëri e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKB me NIPT L61517025M, datë 15/03/2016 regjistrimi, me seli në Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.5, rruga Perlat Rexhepi, Pallati 1, Katë 1, Ap.10, Shqipëri.

5. **Hidrocentrali/et:** Hidrocentrali, me vendndodhje në Qarkun Lezhë, me pozicion gjeografik të veprës së marrjes ( $X=4406705.6$   $Y=4620435.7$   $Z=223$ ), dhe të godinës së centralit ( $X=4406946.6$   $Y=4620479.7$   $Z=160$ ), me fuqi të instaluar 250 (dyqindesëdhjetë) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 890,362 (tetëqindnëntëdhjetë e treqindegjashtëdhjetë) kWh, i përbërë nga tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë por pa u kufizuar në to: veprën e marrjes, kanalin e devijimit, bazenin e presionit, tubacionin që dërgon ujin në turbina, lidhjen me sistemin, ndërtesën e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e intaluara në të.
6. **Objekti:** Financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, shfrytëzim, administrimi, i hidrocentralit/eve.
7. **Investimi:** Vlera totale në lekë që do të shërbejë për ndërtimin dhe paisjen me makineritë e nevojshme të hidrocentralit, si dhe çdo shpenzim tjetër të nevojshëm për mirëmbajtjen e impianteve deri në fillimin e prodhimit të energjisë elektrike.
8. **Punimet:** Tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik, ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentralit "Rrëshen", në përputhje me projektin e zbatimit.
9. **Vënia në punë e hidrocentralit:** Fillimi i prodhimit të energjisë elektrike.
10. **Leje dhe Liçenca:** Akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatës publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin në fuqi.
11. **Operimi:** Të gjitha veprimet e mbajtësit të miratimit, për prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.
12. **Royalty:** Sasia vjetore e energjisë elektrike e shprehur në përqindje, që do i jepet falas ministrisë.
13. **Llogaritja e afateve:** Kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas ditës së pushimit.
14. **Sigurimi i kontratës:** Vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme ose në një shoqëri sigurimesh, me qëllim që të garantojë ministrinë në rastin e shkeljes së kontratës nga shoqëria, sipas nenit 22, shkronja "f" e VKM-së Nr. 822, datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", i ndryshuar.
15. **Ligj:** Nënkupton çdo ligj organik, dekret, vendim të Këshillit të Ministrave ose çdo ligj tjetër që shpallet si i tillë, rregullore, udhëzim, urdhër, licencë, leje, autorizim ose çdo akt tjetër ligjor i shpallur nga Republika e Shqipërisë, vendime gjyqësore që kanë karakter unifikues, akte zyrtare të lëshuara nga çdo organ qëndror dhe/ose vendor, ashtu siç mund të ndryshojnë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.
16. **Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë (ERE):** Është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike që vepron sipas Ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015.

**Aneks:** Çdo deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga palët që i bashkëlidhet kësaj Kontrate dhe/ose çdo leje, licence, kontratë ose dokument tjetër lëshuar nga autoritete shtetërore që shërbejnë ne ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, janë pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj, tani apo në të ardhmen.

18. **Instrument Financiar:** Nënkupton çdo marrëveshje huaje, kredie, marrëveshje siguruese ose çdo instrument tjetër/i përdorur nga mbajtësi i miratimit në lidhje me financimin e objektit gjenerues të energjisë HEC-i "Rrëshen", duke përfshirë çdo ndryshim, shtesë, rinovim apo zëvendësim të secilit prej këtyre instrumenteve.
19. **Pala Financuese:** Nënkupton institucionet financiare të licencuara si të tilla, që do të ndihmojë mbajtësin e miratimit në financimin e objektit HEC-i "Rrëshen".
20. **"Shesh"** do të thotë sheshi që gjendet në rrjedhën e pellgut ujëmbledhës të përroit të Rrëshenit, degë e lumit Fan i Vogël, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, në përputhje me komponentet e veprave të përcaktuara në Projektin e zbatimit të miratuar.
21. Përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe, në këtë Kontratë:
  - i. Njëjësi e përfshin shumësin dhe anasjelltas;
  - ii. Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjënjë;
  - iii. Çdo frazë që fillon me fjalët "duke përfshirë", "përfshin", "në veçanti", "për shembull", të tilla si apo të ngjashme, do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;
  - iv. Titujt e përdorur për nenet, paragrafët, nën paragrafët, Aneksat dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate;
  - v. Referimet në dispozitat dhe Aneksat janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe anekset e kësaj Kontrate.

## Neni 2 Objekti i kontratës

Në bazë të ligjit nr.43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe në VKM-në nr.822, datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni" i ndryshuar, ministria i jep shoqërisë "Nikolli Energy" sh.p.k., të drejtën e Financimit, projektimit, ndërtimit, vënies në punë, shfrytëzimit, administrimit të Hidrocentralit "Rrëshen", në pellgun ujëmbledhës të përroit të Rrëshenit, degë e lumit Fan i Vogël, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

## Neni 3 Të dhëna të përgjithshme të hidrocentralit

1. **Hidrocentrali** do të shfrytëzojë ujërat e përroit të Rrëshenit, degë e lumit Fan i Vogël, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, me pozicion gjeografik të ndërtesës së centralit "Rrëshen" dhe me koordinata, të veprës së marrjes ( $X=4406705.6$   $Y= 4620435.7$   $Z= 223$ ), dhe të godinës së centralit ( $X= 4406946.6$   $Y= 4620479.7$   $Z= 160$ ).
2. Ky projekt do të ketë një hidrocentral me parametrat teknikë e hidroenergjetikë si më poshtë:

- Hidrocentrali "Rrëshen"

Faqe 4 nga 14

<input type="checkbox"/> Kuotat e veprave	223	m m.n.d
- Kuota e veprës së marrjes	160	m m.n.d
- Kuota e godinës së centralit		
<input type="checkbox"/> Fuqia e instaluar (kW) -	N = 250	kW
<input type="checkbox"/> Energjia mesatare vjetore kWh -	E = 890,362	kWh/vit

Projekti mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve i cili mund të përmirësohet por duke ruajtur termat e përcaktuara në këtë kontratë. Karakteristikat e detajuara të hidrocentralit sipas Aneksit nr. 3 bashkëlidhur.

#### Neni 4 Kohëzgjatja e kontratës

1. Kohëzgjatja e kontratës do të jetë prej 49 (dyzetënëntë) vjetësh nga Data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate me të drejtë ripërsëritje sipas përcaktimeve të pikës 3 të këtij neni.
2. Shtyrja e kohëzgjatjes së kontratës do të bëhet nëse palët bien dakord me marrëveshje të nënshkruar prej të dy palëve.
3. Palët bien dakord të ripërsërisin afatin e kontratës me një kërkesë me shkrim pranë ministrisë dhe jo më vonë se një vit nga përfundimtar i afatit të kontratës.
4. Në rast të përfundimit të kontratës në afat, mbajtësi i miratimit është i detyruar të dorëzojë/transferojë veprat energjetike (objekt i kësaj kontrate) tek ministria. Modalitetet e dorëzimit do të përcaktohen mes palëve.

### KREU II TË DREJTAT DHE DETYRIMET E MINISTRISË

#### Neni 5 Monitorimi dhe Mbikëqyrja e Përgjithshme

MIE, ka të drejtë që gjatë periudhës së ndërtimit të HEC, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë dhe mbikëqyrë objektin për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e ndërtimit të tij.

Megjithatë, MIE mund të ushtrojë këtë monitorim dhe mbikëqyrje në çdo kohë në rast se ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve të kësaj Kontrate. Rezultatet e monitorimit do t'i bëhen të njohura mbajtësit të miratimit me shkrim.

#### Neni 6 Detyrimet e ministrisë

MIE merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Të sigurojë vazhdimësinë e kësaj kontrate pavarësisht ndryshimeve të objektivave të Sektorit Elektroenergetik Shqiptar.

Faqe 5 nga 14

2. MIE, me kërkesë të mbajtësit të miratimit, nëse e sheh të arsyeshme, mund të ndihmojë këtë të fundit tek organet shtetërore për çdo pengesë që mund të haset në kuadër të pajisjes me leje, licenca, autorizime apo çdo lloj tjetër leje që nevojitet për ekzekutimin e punimeve dhe operimin e kësaj veprë. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm kur mospajisja me leje, licencë, autorizim, etj, vjen si rezultat i mospërmbushjes së kërkesave ligjore përkatëse për shkak të mbajtësit të miratimit.
3. MIE merr përsipër të mbështesë mbajtësin e miratimit për lidhjen e centralit me Rrjetin Elektrik Kombëtar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.
4. Me kërkesën e mbajtësit të miratimit, blerësi, i energjisë elektrike është i detyruar të blejë të gjithë sasinë e energjisë së prodhuar në zbatim të kontratës tip, të përcaktuar dhe miratuar nga ERE, për një periudhë jo më shumë se ajo e përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Blerësi paguan Shitësin për Energjinë Elektrike të blerë, me çmimin e përcaktuar dhe të miratuar nga ERE sipas legjislacionit në fuqi. Çmimi i aplikueshëm në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate është çmimi në fuqi i përcaktuar dhe miratuar nga ERE.

### KREU III TË DREJTAT DHE DETYRIMET E MBAJTËSIT TË MIRATIMIT

#### Neni 7 Detyrimet e mbajtësit të miratimit

Mbajtësi i miratimit është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektin e Kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

1. Të marrë të gjitha lejet dhe licencat e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
2. Të zbatojë preventivin e paraqitur sipas Aneksit 1 bashkëlidhur kontratës.
3. Të marrë masa që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuara në grafikun e punimeve, pjesë e kësaj kontrate.
4. Të zbatojë projektin për ndërtimin e hidrocentralit, me fuqi totale të vendosur sipas projektit të zbatimit.
5. Të administrojë projektin për kohëzgjatjen e kontratës.
6. Të parandalojë dhe kontrollojë çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë punim i tij dhe të kthejë ambientin, me shpenzimet e veta, në situatën e mëparshme sipas detyrimeve të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për mjedisin, apo çdo institucion tjetër përgjegjës.
7. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen ministrisë apo palëve të treta.
8. Të mbajë të informuar MIE për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
9. Të zbatojë Marrëveshjen e Lidhjes me Rrjetin e Shpërndarjes/Transmetimit konform kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga OSHEE/OST.

- J. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjenës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.
11. Mbjtësi i miratimit nuk duhet të ndërhyjë në burimet ujore që furnizojnë ujësjellësin e zonës.
12. Mbjtësi i miratimit duhet të marrë masa për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit në fuqi për ruajtjen e ekosistemit natyror, si dhe të sasisë së ujit ekologjik në shtratin parësor të burimit ujor (lumit/përroit) në përputhje me rregullat ligjore në fuqi.
13. Mbjtësi i miratimit duhet të sigurojë ujin e nevojshëm për vaditje, në përputhje me nevojat e bujqësisë dhe legjislacionin në fuqi për rezervat ujore.
14. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi.
15. Në kuadër të zbatimit të punimeve për realizimin e projektit, bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, mbjtësi i miratimit është i detyruar të emërojë një subjekt në rolin e mbikëqyrësit të punimeve. Ai mund të jetë person fizik, juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

### Neni 8 Vlerësimi i Investimeve

1. Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga mbjtësi i miratimit janë në vlerën totale prej 47,652,406 (katërqindeshtatëdhjetë milion e gjashtëqindpesëdhjetë mijë e katërqindgjathtë) lekë pa TVSH, sipas Aneksit nr. 1 bashkëlidhur.
2. Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve, në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës.

### Neni 9 Programi punimeve

Mbjtësi i miratimit merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve:

1. Merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pajisjes me lejen e nevojshme për fillimin e punimeve të ndërtimit.
2. Merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, siç është parashikuar në grafikun e punimeve të paraqitur në Aneksin 2, bashkëlidhur. Afati i aplikimit në përputhje me rregullat e përcaktuara nga strukturat shtetërore, për pajisjen me lejet e nevojshme është jo me shume se 12 muaj nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës.
3. Këto afate, mund të ndryshohen me marrëveshje midis MIE dhe mbjtësit të miratimit vetëm një herë dhe ky afat i ndryshuar nuk mund të jetë më i gjatë se gjysma e periudhës së ndërtimit.
4. Në rast të ndryshimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, Mbjtësi i miratimit është i detyruar të njoftojë edhe OSHEE/OST.

### Neni 10

Faqe 7 nga 14

## Testimi i veprës

1. Në përfundim të punimeve, për të siguruar funksionimin e hidrocentralit, duhet të kryhet testimi i veprës. Testimi do të fillojë brenda 45 (dyzetepesë) ditëve nga marrja e njoftimit të bërë nga mbajtësi i miratimit tek MIE.
2. Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të ministrisë ose të autorizuarit prej tij dhe të mbajtësit të miratimit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të hidrocentralit, brenda 45 ditëve nga fillimi i testimit.
3. Në rast mospjesëmarrjeje të përfaqësuesit/përfaqësuesve të MIE gjatë testimit, mbajtësi i miratimit ka të drejtë të kryejë vetë testimin dhe vënien në punë të veprës, duke njoftuar ministrinë me shkrim, brenda 30 ditëve nga testimi dhe vënia në punë.

### Neni 11 Zgjidhja e Kontratës

#### I. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga ministria.

MIE ka të drejtë të zgjidhë kontratën duke vendosur heqjen e miratimit të ndërtimit kur Mbajtësi i miratimit nuk ka plotësuar detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në aktin e miratimit si dhe:

1. Nëse mbajtësi i miratimit nuk ka zbatuar grafikun e punimeve dhe nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi që ministria i ka bërë mbajtësit të miratimit, ky i fundit nuk justifikon mosrealizimin e detyrës dhe nuk dokumenton mundësitë e tij për të përfunduar në datën e përcaktuar objektin ose ndonjë fazë të tij;
2. Nëse mbajtësi i miratimit nuk ka dorëzuar në MIE, çdo 3 muaj duke filluar nga data e miratimit të ndërtimit, një raport mbi veprimtarinë e tij për ndërtimin e hidrocentralit dhe nëse brenda një afati prej 15 ditësh, pas njoftimit paraprak nga MIE, mbajtësi i miratimit përsëri nuk dërgon informacionin e kërkuar;
3. Nëse vërtetohet se deklaratimet e mbajtësit të miratimit nuk janë të vërteta;
4. Kur për mbajtësin e së drejtës së ndërtimit kanë filluar procedurat e falimentimit ose likuidimit, sipas legjislacionit në fuqi;
5. Kur mbajtësi i së drejtës së ndërtimit nuk plotëson një/disa nga detyrimet e përcaktuara në nenin 7 të kontratës.
6. Kur mbajtësi i miratimit transferon aksionet/kuotat e veta tek të tretët, pa miratim të ministrisë.
7. Kur mbajtësi i miratimit braktis punimet e zbatimit për më shumë se 100 (njëqind) ditë të njëpasnjëshme. Në këtë rast ministra ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në nenin 12 të kësaj kontrate, pa pasur asnjë detyrim të çdo lloji karshi mbajtësit të miratimit.
8. Kur mbajtësi i miratimit nuk zbaton në mënyrë të përsëritur një/disa nga detyrimet e tij të parashikuara në këtë Kontratë, të bëra të ditura nga MIE në mënyrë shkresore.
9. Kur nuk siguron financimin e projektit brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës.



10. Mbjtësi i miratimit njofton me shkrim OSHEE/OST për zgjidhjen e kontratës brenda një afati 10 ditor.

II. Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga mbajtësi i miratimit:

Mbjtësi i miratimit, ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë duke i drejtuar kërkesë me shkrim MIE në të cilën të arsyetohen shkaqet dhe të jepen justifikimet e arsyeshme për këtë kërkesë.

III. Zgjidhja e kontratës nga secila palë:

Secila nga palët ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur:

1. Megjithë plotësimin e kriterëve nga ana e mbajtësit të miratimit për aplikim për leje, licenca, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe ndërhyrjen e ministrisë, mbajtësi i miratimit nuk është pajisur me to për arsye ligjore, për fillimin e punimeve dhe/ose operimin e Projektit.
2. Vazhdimi i saj bëhet i pamundur jo për faj të mbajtësit të miratimit.
3. Në rastet e parashikuara nga neni 7 i kësaj kontrate.
4. Kur ka shkelje serioze nga njëra palë dhe kjo shkelje nuk korrigjohet brenda afatit kohor dhe mënyrës së parashikuar në kontratë.

IV. Njoftimi i zgjidhjes së kontratës

Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate në përputhje me këtë nen, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër. Njoftimi duhet të përmbajë:

- i. Detajet e duhura duke nënvizuar shkakun e zgjidhjes;
- ii. Datën e përfundimit të kontratës, në rast të moskorrigjimit të shkeljes brenda 40 ditëve nga data e njoftimit;
- iii. Hollësitë e llogaritjes së pagesave si rezultat i zgjidhjes së kontratës;
- iv. Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

V. Zgjidhja e kontratës me konsensus:

Palët kanë të drejtë ta zgjidhin këtë kontratë me pëlqim të dyanshëm. Gjithsesi, mbajtësi i miratimit ka të drejtë të kërkojë Sigurimin e Kontratës, me kusht që të ketë paguar kompensimin e rënë dakord me negociim midis dy palëve.

VI. Në të gjitha rastet e zgjidhjes së kontratës, ose të përfundimit të saj Ministria, do të marrë në pronësi dhe do të administrojë më tej veprën/projektin.

**Neni 12**  
**Sigurimi i kontratës**

1. Mbjtësi i miratimit, para nënshkrimit të kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të ministrisë, një shumë prej 2,382,620.3 (dy milion e treqindetëdhjetë e mijë e

gjashtëqindnjëzet pikë tre) lekë, që përbën 5% të vlerës totale të investimit. Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkëlidhet kësaj kontrate.

2. Mbajtësit të miratimit i lejohet të ç'ngurtësojë 98% (nëntëdhjetetë për qind) të vlerës së sigurimit të kontratës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e testimit të veprës. Ndërsa pjesën e mbetur prej 2% (dy për qind) të vlerës së sigurimit të kontratës do të ç'ngurtësohet në përfundim të periudhës së kohëzgjatjes së kontratës, sipas nenit 4 të kësaj Kontrate.

### **Neni 13 Sigurimet**

1. Mbajtësi i miratimit duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të paktën nga rreziqet e parashikuara në Ligjin nr.52/2014, dt. 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" gjatë gjithë periudhës së jetëgjatësisë së hidrocentralit dhe do të dorëzojë pranë MIE një kopje të tij çdo vit, brenda një afati 15 ditor nga data e sigurimit.
2. Mbajtësi i miratimit duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.

### **Neni 14 Royalty**

Mbajtësi i miratimit duhet të japë në formë royalty, falas Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë 2 % (dy për qind) të sasisë vjetore të energjisë elektrike.

Në rast konvertimi në vlera monetare, këto të ardhura do të derdhen tërësisht në Buxhetin e Shtetit.

### **Neni 15 Kufizimet**

Për çdo transferim të aksioneve/të kapitalit themeltar tek të tretët, mbajtësi i miratimit duhet të marrë pëlqimin paraprak të ministrisë. Në këtë rast palës së tretë do ti transferohen dhe detyrimet apo të drejtat e përcaktuara në këtë kontratë.

### **Neni 16 Raportimi**

Mbajtësi i miratimit është i detyruar që çdo 3 (tre) muaj të raportojë me shkrim pranë MIE, për veprimtarinë e tij të ndërtimit të burimit gjenerues të energjisë, hidrocentralit "Rrëshen".

### **Neni 17 Legjislacioni i zbatueshëm**

Lidhja, zbatimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

### **Neni 18 Forca Madhore**

Faqe 10 nga 14

1. "Forca madhore" nënkupton çdo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme dhe objektive është absolutisht tej parashikimit dhe kontrollit, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të palës së cënuar që rezulton ose shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të palës së cënuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:

- a. kjo rrethanë në mënyrë objektive dhe absolute, nuk mund të parandalohej apo nuk ishte e mundur të parandalohej, shmangej ose mënjanohet nga pala e cënuar;
- b. pala e cënuar ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shmangte pasojën e këtij rasti në aftësinë e palës së cënuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj kontrate dhe për të zbutur pasojat e saj;
- c. ngjarja nuk është ose nuk ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga pala e cënuar të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate, dhe
- d. pala e cënuar t'i ketë dhënë njoftim në afatin e rënë dakord palës tjetër (pala e pacënuar)

2. Konsiderohen Ngjarje të Forcës Madhore:

- a. Katastrofat e natyrës, përmytjet, tërmetet, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to;
- b. Lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, bllokada, embargo që zgjasin për një kohë jo më të vogël se një muaj;

3. Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 30 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e përmbushjes së detyrimeve në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën. Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore. Kufijtë e përmbushjes së detyrimeve, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre. Periudha e jetëgjatësisë së hidrocentralit do të zgjatet në përputhje me nenin 4 të kësaj kontrate.

4. Zgjidhja e kontratës për shkak të forcës madhore

Pala e prekur nga forca madhore ka të drejtë të zgjidhë kontratën:

- a. në rast se edhe pas zbatimit të pikës 2 të këtij neni, nuk është arritur një zgjidhje në të mirë të projektit.
- b. kur forca madhore zgjat më tepër se 1 (një) muaj.

5. Pasojat e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore

Në rastet e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore, palët nuk kanë detyrime ndaj njëra - tjetrës dhe secila palë do të përballojë kostot e veta.

6. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve që vijnë si pasojë e forcës madhore do të bëhet në përputhje me nenin 20 të kësaj kontrate.

**Neni 19**  
**Hyrja në fuqi e Kontratës**


1. Kontrata do të hyjë në fuqi pasi të nënshkruhet nga palët, në përputhje me VKM-në nr. 822, date 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", i ndryshuar.

**Neni 20**  
**Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

1. Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.
2. Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë, do të jetë Gjykata kompetente për zgjidhjen e konflikteve administrative.
3. Fillimi apo vazhdimi i procedurave për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë, nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës përveç kur objekti i mosmarrëveshjes është zgjidhja e kësaj kontrate dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.

**Neni 21**  
**Sanksionet**

1. Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, në përfundim të periudhës të parashikuar në nenin 9 të kësaj kontrate, penalizon mbajtësin e miratimit si më poshtë:
  - i. Për çdo ditë vonesë për fillimin e punimeve penalizohet me 10,000 lekë.
  - ii. Për çdo ditë vonesë të vënies në punë (pas fillimit të punimeve të vërtetuara me aktet zyrtare të fillimit të punimeve) penalizohet me 5000 lekë.
2. Mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike sipas kushteve të rëna dakord me këtë kontratë, penalizon mbajtësin e miratimit si më poshtë:
  - i. Në rast mosrealizimi, të prodhimit të energjisë elektrike prej 890,362 mbajtësi i miratimit penalizohet duke i marrë të plotë tarifën royalty prej 2 % (për sasi prej 17.807.24 kWh/vit).
3. Shuma e përgjithshme e penaliteteve të mësipërme nuk mund të tejkalojë vlerën e 10 % të vlerës së përgjithshme të investimit referuar nenit 8 të kësaj Kontrate.
4. Sanksionet paguhen nga mbajtësi i miratimit në llogari të ministrisë. Ministria njofton me shkrim mbajtësin e miratimit për shkeljet e konstatuara që çojnë në aplikimin e sanksioneve dhe në rast kundërshtie apo ankese të këtij të fundit, për shkeljet e konstatuara që çojnë në aplikimin e sanksioneve, Palët do të mblidhen për të arritur një zgjidhje brenda 1 muaji nga njoftimi për shkeljet e konstatuara që kanë çuar në aplikimin e sanksioneve.
5. Kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, ministrisë i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 20 ditësh nga data e marrjes së njoftimit prej mbajtësit të



miratimit. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, ministria ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.

6. Aplikimi dhe pagimi i penaliteteve sipas këtij neni nuk e çliron mbajtësin e miratimit nga përmbushja e detyrimeve dhe parashikimeve të kësaj kontrate.
7. Këto penalitete do të mbahen nga Sigurimi i Kontratës parashikuar në nenin 12 të kësaj kontrate, duke patur parasysh se nëse vlera e këtij sigurimi nuk është e mjaftueshme për shlyerjen e penaliteteve, mbajtësi i miratimit do t'a plotësojë këtë shumë, rast pas rasti.

#### **Neni 22 Rregullimi i shkeljeve**

1. Kur MIE konstaton se gjatë periudhës së jetëgjatësisë së objektit gjenerues të energjisë HEC-it "Rrëshen" mbajtësi i miratimit ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje mbajtësit të miratimit duke pritur për një periudhë 40 ditore përgjigjen e tij, me argumentet përkatëse. Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.
2. Kjo procedurë nuk e zhvesh mbajtësin e miratimit nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospërmbushja e detyrimeve.

#### **Neni 23 Mbarimi i kontratës**

1. Kontrata mbaron me përfundimin e afatit sipas parashikimet të nenit 4 të kësaj kontrate.
2. Mbarimi i kontratës sipas përfundimit të afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e zhvesh mbajtësin e miratimit nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj ministrisë dhe të tretëve.


#### **Neni 24 Konfidencialiteti**

Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

#### **Neni 25 Ndryshime**

1. Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve.
2. Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Faqe 13 nga 14



**Neni 26**  
**Bashkëpunimi midis Ministrisë dhe Mbajtësit të Miratimit**

MIE dhe mbajtësi i miratimit janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të bëhet vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 10 (dhjetë) ditor nga data e ndryshimit.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkohet ministrisë nga mbajtësi i miratimit, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate.

Adresat dhe numrat e kontaktit që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Kontrate janë:

Për ministrinë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë  
Adresa: Rruga "Abdi Toptani Nr.1,  
Tiranë - Shqipëri.

Për mbajtësin e miratimit

Shoqëria "Nikolli Energy" sh.p.k.  
Adresa: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.5,  
rruga Perlat Rexhepi, Pallati 1, Kati 1,  
Ap.10, Shqipëri.

**Neni 27**

Kjo Kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.


Kontrata u hartua në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noter/ja e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

**PALËT**

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**

**Përfaqësuar nga :**



**Z. Agim Bregasi**


  



**Shoqëria "Nikolli Energy" sh.p.k.**

**Përfaqësuar nga :**


**Z. Arber Nikolli**













Faqe 14 nga 14

**ÇERTIFIKATE GARANCIE KONTRATE**  
Nr.46454061

Date: 27.11.2018

**PER: MINISTERIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE.**  
Blv.Deshmoret e Kombit,1001,Tirane

Duke qene se Shoqeria "Nikolli Energy" Sh.p.k me nipt (L61517025M). Me adrese: Tirane,Njesia nr 5,Rruga Perlat Rexhepi,Pallati1,Shkalla2,Kati 1,Apartamenti 10. Tirane, ka marre persiper ne baze te Miratimit Perfundimtar Nr. 14360/1 Dt. 23.11.2018.Te realizoje: Ndertimi i burimit te ri gjenerues te Energjise, Hidrocentralit "Rreshen", ne Ujrat e Perrojtit te Rreshenit, Bashkia Mirdite, Qarku Lezhe.

Duke qene se ne Kontraten si me siper kerkohet Garanci ne Shumen prej 2,382,620.3 (dymilion e treqind e tedhjte e dy mije e gjashteqind e njezet pike tre) leke.

Si sigurim per permbushjen e detyrimeve te parashikura ne kontrate.

Duke qene se e sigurimit "ALBSIG SHA" eshte garantues i zbatimit te kontrates se mesiperme ose i pageses deri ne shumen totale, prej 2,382,620.3 (dy milion e treqind e tedhjte e dy mije e gjashteqind e njezet pike tre )leke e cila eshte e pagushme ne menyren dhe monedhen e percaktuar ne kontrate.

Ne marrim persiper si shoqeri sigurimi "ALBSIG SHA" ti paguajme **Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise, Tirane**, me nr nipti **L72413451B** sapo te beje kerkesen e pare me shkrim per çdo shkak te mundshem, te matshem, te provueshem, te pa parashikuar, te ligjshem dhe jashte kontrollit te paleve te çdo shume te pa paguar nga shoqeria Nikolli Energy shpk brenda kufirit prej shumes2,382,620.3 (dymilion e treqind e tedhjte e dy mije e gjashteqind e njezet pike tre) Leke, ne perputhje me kontraten konçesionare qe do te lidhet.

Me kete Garanci ju sigurojm se nuk eshte nevoja ti drejtoheni me pare shoqerise "Nikolli Energy" Sh.p.k per te realizuar pagesen sipas kerkeses suaj.

Deklarojm gjithashtu se asnje shtese apo ndryshim i kushteve te kontrates per te cilen ju mund te bini dakort me kontraktuesin nuk na çliron nga detyrimet e kesaj Garancie, por siguruesi duhet te njoftohet me shkrim.

**Vlefshmëria** e kësaj Çertifikate Garancie është e vleshme 30 dite nga data e leshimit te Çertifikates se Perfundimit (kryrja e testimit te vepres dhe venjes ne pune) por jo me vone se 24 muaj nga data e leshimit dhe nuk i kalon afatet ligjore te vendosura dhe te rena dakort midis paleve ne Kontraten e Konçensionit si dhe akteve ligjore ne zbatim te kontrates.

Leshuar ne Lezhe me dt.27.11.2018, ne perputhje me Autorizimin Nr.10, dt. 19.07.2004, leshuar nga Komisioni i Mbikqyrjes se Sigurimeve(K.M.S.), sot Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (A.M.F.), bazuar ne dispozitat e Ligjit 9267, dt. 29.07.2004 "Per Veprimtarine e Sigurimit, te Risigurimit dhe Ndermjetesimit ne Sigurime", ndryshuar me Ligjin Nr.52/2014, dt. 22.05.2014 "Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit" Kodi Civil te Republikes se Shqiperise.

**SIGURUESI**



**Aneksi 1**  
**(Preventivi i punimeve)**





**EVENTIVI I PUNIMEVE HIDROCENTRALI "RËSHËN", QARKU LEZHË.**


NR.	PERSHKRIMI I PUNES	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLERA
1	2	3	4	5	6

**1. PUNIMET CIVILE**

A	Nr.An	VEPRA E MARRJES				
1		Punime per devijimin e ujit nga aksi i diges	leke	1.000	300,000.00	300,000.00
2	3.107/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 1.0 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke	m <sup>3</sup>	450.000	300.00	135,000.00
3	3.125/b	Germim shkemb i coptuar me ekskavator 1.0 m <sup>3</sup> , shkemb, ne themele gjeresi >2 m, me shkarkim ne toke	m <sup>3</sup>	70.000	600.00	42,000.00
4	3.158/2a	Transport dheu me auto deri 2.0 km	m <sup>3</sup>	520.000	170.00	88,400.00
5	3.182/a	Shtrese rere natyrore t=10cm	m <sup>2</sup>	300.000	287.00	86,100.00
6	3.161/1	Rrafshim skarpate ne germim, ekskavator 0.5 m <sup>3</sup>	m <sup>2</sup>	12.000	35.00	420.00
7	3.4	Prerje e sistemim pemesh ø 21 - 40 cm	cope	10.000	207.00	2,070.00
8	3.237	Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% gur	m <sup>3</sup>	600.000	8,039.00	4,823,400.00
9	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m <sup>3</sup>	120.000	11,494.00	1,379,280.00
10	3.310	Kallep me derrasa te veçuara, per fuga	m <sup>2</sup>	12.000	4,452.00	53,424.00
11	3.288	F.V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm. Furnizim - vendosje hekur ne dige	ton	9.250	106,741.00	987,354.25
12	3.331	Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m	m <sup>3</sup>	25.000	5,536.00	138,400.00
13	3.353	Mbushje me shkemb te germuar me pare	m <sup>3</sup>	20.000	637.00	12,740.00
14	An-58	Izolimi i ujrave ne fuga pas betonimit	ml	20.000	1,517.00	30,340.00
15		Furnizim-Vendosje zgarre metalike per marrjen e ujit sipas specifikimeve te projektit	ton	0.300	106,741.00	32,022.30
16		F.V porte metalike b*h=1750*1200 mm, 1700*1200	kg	175.000	366.00	64,050.00
<b>Shuma 1</b>						<b>8,175,000.6</b>

B	DEKANTUESI +BASENI I PRESIONIT					
1	3.107/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 1.0 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke	m <sup>3</sup>	88.000	300.00	26,400.0
2	3.125/b	Germim shkemb i coptuar me ekskavator 1.0 m <sup>3</sup> , shkemb, ne themele gjeresi >2 m, me shkarkim ne toke	m <sup>3</sup>	28.000	600.00	16,800.0
3	3.158/2a	Transport dheu me auto deri 2.0 km	m <sup>3</sup>	116.000	170.0	19,720.0
4	3.182/a	Shtrese rere natyrore t=10cm	m <sup>2</sup>	125.000	287.0	35,875.0

PREVENTIVI HEC RESHEN




	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m <sup>3</sup>	84.500	11,494.0	971,243.0
6	3.786	Kallepe me lende druri, per kollona, trare, e soleta	m <sup>2</sup>	18.000	4,452.0	80,136.0
7	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 per shkarkuesin	m <sup>3</sup>	2.000	10,674.0	21,348.0
8		Furnizim - vendosje porta metalike (600x1500mm -1 cope, 1000x1000 mm etj sipas projektit )	kg	666.250	366.0	243,847.5
9		Furnizim - vendosje porta elektro-mekanike ne basenin e presionit	cope	0.650	986,000.0	640,900.0
10	An-9	Mbushje me zhavorr pas mureve	m <sup>3</sup>	12.000	1,037.0	12,444.0
11	3.288	F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm. Furnizim - vendosje hekur ne trup te vepres	ton	7.370	106,741.0	786,681.2
<b>Shuma 2</b>						<b>2,855,394.7</b>

C		TUBACIONI I TURBINAVE				
1	3.107/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 1.0 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke	m <sup>3</sup>	1116.000	175.00	195,300.0
2	3.125/b	Germim shkemb i coptuar me ekskavator 1.0 m <sup>3</sup> , shkemb, ne themele gjeresi >2 m, me shkarkim ne toke	m <sup>3</sup>	20.000	160.00	3,200.0
3	cmim oferte	Furnizim vendosje tubacion celiku D=650mm, D=600mm, D=550mm, L=295m	ton	27.800	141,566.77	3,935,556.3
4	An.164/1a	Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m <sup>3</sup>	883.000	614.00	542,162.0
5	An-9	Mbushje me zhavorr pas mureve	m <sup>3</sup>	408.000	1,037.0	423,096.0
6	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 . Beton per ankerat horizontale dhe vertikale dhe boxet e kalimit te lumit C 16-20 faza e pare.	m <sup>3</sup>	36.000	10,674.00	384,264.0
7	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 . Beton per ankerat horizontale dhe vertikale dhe boxet e kalimit te lumit C 20/25 faza e dyte	m <sup>3</sup>	30.000	11,494.00	344,820.0
8	3.288	F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm. Hekur betoni per ankerat	ton	2.900	106,741.00	309,548.9
<b>Shuma 3</b>						<b>6,137,947</b>

D		NDERTESA E CENTRALIT				
1	3.107/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 1.0 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne toke	m <sup>3</sup>	450.000	175.00	78,750.0
2	3.125/b	Germim shkemb i coptuar me ekskavator 1.0 m <sup>3</sup> , shkemb, ne themele gjeresi >2 m, me shkarkim ne toke	m <sup>3</sup>	315.000	160.00	50,400.0

PREVENTIVI HEC RESHEN



	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m <sup>3</sup>	100.000	11,494.00	1,149,400.0
4	3.288	F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm.	ton	8.000	106,741.00	853,928.0
5	2.126	Soleta b/a monolite me tulla me 6 vrima, Hd = 6m, trashesi 25cm C 15/20	m <sup>2</sup>	285.000	3,274.00	933,090.0
6	7	Punime te brendshme ne godine	leke	1.000	450,000.00	450,000.0
7	3.243	Struktura monolite betoni C 20/25. Betone per bazamentet e transformatorit	m <sup>3</sup>	37.000	11,494.00	425,278.0
8	2.390/1	F.V dyer metalike me llamarine te zeze 27.75 kg/m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	12.500	6,016.00	75,200.0
9	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25	m <sup>3</sup>	165.000	11,494.00	1,896,510.0
					<b>Shuma 4</b>	<b>5,912,556.0</b>

<b>E</b>		<b>LIDHJA ME SISTEMIN</b>				
	1	Parashikuar ne nje lidhje me N/Stacionin Reps	leke	1.0	5,352,345	5,352,345
					<b>Shuma 5</b>	<b>5,352,345</b>

<b>TOTALI PUNIME CIVILE (1+2+3+4+5+6+7+8)</b>						<b>28,433,243</b>
---	--	--	--	--	--	-------------------

<b>2. PAJISJE ELEKTRO-MEKANIKE</b>						
	1	Furnizim turbine dhe pajisjeve elktro-mekanike te lidhura me te	leke	1.000	12,600,000	12,600,000
	2	Instalim turbine dhe pajisjeve elktro-mekanike te lidhura me te	leke	1.000	1,000,000	1,000,000
					<b>Shuma 6</b>	<b>13,600,000</b>

<b>I MJEDISI</b>						
	1	Regullimi i Mjedisit	leke			
					<b>Shuma 7</b>	<b>1,000,000</b>

<b>J PROJEKTI</b>						
		Hartimi i projekt zbatimit	leke			
					<b>Shuma 8</b>	<b>700,000</b>


<b>K Liçenc. Shpenz. Pregatitore</b>						
	1	Liçencimi dhe lejat e marra	leke			450,000
	2	Shpenzime te tjera pregatitore	leke			1,200,000
					<b>Shuma 9</b>	<b>1,650,000</b>

<b>3. TOTALI PUNIME CIVILE + PAJISJE ELEKTRO-MEKANIKE</b>						
		FOND REZERVE	5%			2,269,162
		TOTALI				47,652,406
		TVSH	20%			9,530,481
		TOTALI				<b>57,182,887</b>

Preventivoi: Ing. Fahri Maho



**Aneksi 2**  
**(Grafiku i punimeve)**



**GRAFIKU I PUNIMEVE NE HIDROCENTRALIN E PELLGUT TE PERROIT TE RESHENI, DEGE E LUMIT MAT, BASENI UJOR MAT, BASHKIA RRESHEN.**

Emertimi HEC-#	Nr.	Pershkrimi i Punimeve	PERIUDHA E NDERTIMIT (12 MUAJ)															
			Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5	Muaji 6	Muaji 7	Muaji 8	Muaji 9	Muaji 10	Muaji 11	Muaji 12				
HEC RRESHEN	1	Ndërtim Rrugësh	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2
	2	Ngritje Kantieri																
	3	Vepra e Marrjes(Kryesore)																
	4	Dekantuesi																
	5	Tubacioni i sifonit																
	6	Tubacioni i derivacionit																
	7	Basen Presioni																
	8	Tubacioni i Turbinave																
	9	Ndërtesa e Centralit																
	10	Instalime Elektro-Mekanike																
	11	Lidhja me Sist. Energjistik																
	12	Testet dhe Kolaudimi i Veprës																

**Page 1**

INVESTITOR: "NIKOLLI ENERGY" Sh.p.k

PER KOMPANINE KONSULENTE "EBS" Sh.p.k

ING. FAHRI MAHO  
PROJEKTIM-AMBIKËQYRJE-KOLAUDIM

**EBS**

